



06 - 08 18

Handwritten signature/initials

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:017603
Datë: 14.06.2018
Numri i dokumentit: 00062200

P.nr. 538/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM
DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren Hysnije Gashi si dhe me zyrtaren ligjore Albana Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1053-5/16 të datës 27.02.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datë 04.06.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari: [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] me nr. personal [REDACTED] i martuar, prind i gjashtë fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 04.04.2016 në kohë të papërcaktuar në fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj, me rastin e kontrollit në shtëpinë e të pandehurit nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS, kanë konstatuar se konsumatori me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetes të i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, është konstatuar se është duke u keqpërdorur energjia elektrike ku ka bërë ndërhyrje të paautorizuar në njehsorin elektrik me numër 3660514, ku ka liruar dhe larguar urat L2 dhe L3 duke anashkaluar njehsorin elektrik ku energjia e shfrytëzuar nuk regjistrohet fare me të cilin rast KEDS është dëmtuar në shumë prej 966.81 €,-

- me të cilën kreu veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4,7,17,41,42,46,49,50,51,52 dhe 73 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPK-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me të cilin e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) euro si dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim të mos ekzekutohen nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari, që për dëmin e shkaktuar të dëmtuarës KEDS, ti paguaj shumën prej 966.81 €.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1053-5/16 të datës 27.02.2017 e ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor, me datën 04.06.2018 në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit në fillim të shqyrtimit gjyqësor lexoi aktin akuzues, ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit mbeti në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të tij, duke kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe ti përcaktohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] konform nenit 325 të KPPK-së në shqyrtimin gjyqësor i është dhënë mundësia për tu deklaruar lidhur me fajësinë, ku i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk është e vërtetë se është kryes i kësaj vepre penalee pranon faktin se ditën kritike punëtorët e KED-sit kan kontrolluar orën në shtëpinë e tij e kanë fotografuar orën elektrike dhe dhe e kanë ndërruar dhe për ate veprim kanë përpiluar proscverbal ti cilin e kishte nënshkruar pa vërejtje .

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se detyrë e tij si punëtor i KEDS-it është që ti kontrollojë njësorët elektrik të konsumatorëve dhe po ashtu deklaroi se me datën 04.04.2016 së bashku me kolegun e tij [REDAKTUAR] kanë qenë në kontroll në shtëpinë e tani të akuzuarit në fshatin [REDAKTUAR] dhe gjatë kontrollit të njësorit kanë hasur në njësorin elektrik i cili nuk ka pasur të vendosur bllobbën distributive, ndërsa pasi kanë hapur kapakun e njësorit elektrik për të kontrolluar hyrjet dhe daljet e energjisë elektrike, kanë hasur në ura të ndaluara L-2 dhe L-3 duke anashkaluar energjinë elektrike të shpenzuar, në atë mënyrë që me rastin e largimit të

këtyre urave nuk bëhet regjistrimi i energjisë së shpenzuar, ndërsa po atë ditë e kanë bërë ndërrimin e njëisorit elektrik dhe e kanë larguar njëisorin e manipuluar.

Gjykata dëshminë e dëshmitarit [REDACTED] e ka vlerësuar si të besueshme pasi që e njëjta mbështetet në provat materiale siç janë procesverbali me nr. 1105632 i dt. 04.04.2016, fatura e dt. 06.04.2016 si dhe fotografitë dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata gjithashtu vlerësoi edhe e mori në konsideratë edhe mbrojtjen e të akuzuarit, mirëpo gjykata një mbrojtjes së tillë nuk e vlerësoi si të besueshme, sepse mbrojtja e të pandehurit është kontradiktore, nuk është e mbështetur në prova dhe fakte, por më shumë është e orientuar nga fshehja e veprimeve inkriminuese me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPRK-së të kryer në kohën, në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ku me rastin e kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit, nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS kanë konstatuar se konsumatori me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetes të i sjell dobi të kundërligjshme e ka keqpërdorur energjinë elektrike në atë mënyrë që në njëisorin elektrik DFE-15906 ku fazat L-2 dhe L-3, kanë qenë të ndaluara, me që rast është anashkaluar matja e energjisë elektrike të shpenzuar ku me këtë rast i ka shkaktuar dëme KEDS-it në shumën prej 966.81 €.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh faktin se nuk ka të dhëna se i akuzuari më parë ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, gjendjen e dobët ekonomike, se është i martuar dhe baba i gjashtë fëmijëve, përkatësisht mbajtës i familjes, ndërsa në mungesë të rrethanave rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale duke i shqiptuar dënim të kushtëzuar si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet

qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Obligohet i akuzuari që për dëmin e shkaktuar, të ia kompensoj KEDS-it shumën në lartësinë prej 966.81 €.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DIVIZIONI PENAL

Departamenti i Përgjithshëm

P. nr. 538/17, me dt. 04.06.2018

Zyrtarja ligjore,

Albana Ujupi

Gjyqtarja,

Hysnije Gashi



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.